



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 34 , datë 21.1.2026

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE  
TË SHPËRNDARJES SË GRANTIT PËR KOMITETIN OLIMPIK  
KOMBËTAR SHQIPTAR, KOMITETIN PARALIMPIK KOMBËTAR  
SHQIPTAR, ORGANIZATËN KOMBËTARE ANTIDOPING,  
FEDERATAT SPORTIVE OLIMPIKE, FONDACIONET SPORTIVE,  
ME THEMELUES INSTITUCIONET PUBLIKE PËRGJEGJËSE  
NË FUSHËN E SPORTIT, DHE KËSHILLIN E ARBITRAZHIT  
SPORTIV**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shpërndarjes së grantit nga buxheti i shtetit, në formë transferte, për organizatat sportive, si më poshtë vijon:
  - a) Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar;
  - b) Komitetin Paralimpik Kombëtar Shqiptar;
  - c) Organizatën Kombëtare Antidoping;
  - ç) Federatat sportive olimpike;
  - d) Fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit;
  - dh) Këshillin e Arbitrazhit Sportiv.
  
2. Organizatat sportive, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë nga granti i buxhetit të shtetit kur plotësojnë kriteret e përgjithshme, shoqëruar me dokumentacionin përkatës për:
  - a) regjistrimin si person juridik, sipas legjislacionit në fuqi;
  - b) miratimin e statutit nga ministri përgjegjës për sportin;

- c) konstituimin e organeve drejtuese, të zgjedhura në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe statutit;
- ç) NIPT-in aktiv dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore;
- d) bilancin financiar të vitit paraardhës, i miratuar sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) përmbushjen e detyrave statutores, në përputhje me llojin e veprimtarisë së organizatës sportive;
- e) administrimin e fondeve publike të akorduara nga ministria përgjegjëse për sportin në llogari bankare të dedikuara;
- ë) raportin financiar periodik për fondet publike të akorduara nga ministria përgjegjëse për sportin;
- f) auditimin e jashtëm të pavarur për fondet publike të akorduara nga ministria përgjegjëse për sportin, për vitin paraardhës;
- g) publikimin e raporteve financiare dhe të informacionit për aktivitetet në faqet e tyre zyrtare.

3. Federatat sportive olimpike plotësojnë dhe kriteret e posaçme, duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës për:

- a) aktivitetet ndërkombëtare të organizuara gjatë vitit kalendarik;
- b) rezultatet e arritura në veprimtari ndërkombëtare për sportet individuale dhe kolektive;
- c) masivitetin, si:
  - i. numrin e organizatave sportive anëtare me status aktiv;
  - ii. numrin e sportistëve të regjistruar në sportet individuale;
  - iii. numrin e sportistëve të regjistruar në sportet kolektive.
- ç) raportin gjinor në organet ekzekutive të organizatës dhe sekretarin e Përgjithshëm;
- d) përfshirjen e personave me aftësi ndryshe intelektuale dhe fizike në aktivitetin sportiv të federatës;
- dh) traditën dhe jetëgjatësinë e federatës kombëtare, përfshirë edhe vitin e themelimit;
- e) numrin total vjetor të organizimit të aktiviteteve kombëtare;
- ë) numrin total vjetor të pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare;
- f) ngritjen e kapaciteteve lidhur me:
  - i. miratimin e planit strategjik afatmesëm për zhvillimin e sportit;
  - ii. trajnime të organizuara për sportistë, trajnerë, arbitra dhe administratorë.
- g) logjistikën e nevojshme për organizimin e Kampionatit Kombëtar dhe Kupës së Shqipërisë, sipas veprimtarisë së organizatës sportive.

4. Zërat e shpenzimeve, që lejohen të përballohen nga fondi “Grant/transfertë korrente e brendshme” për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komitetin Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizatën Kombëtare Antidoping, fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, dhe Këshillin e Arbitrazhit Sportiv, janë:
  - a) financimi i shpenzimeve të personelit, sipas strukturës organizative të miratuar nga organet vendimmarrëse, në masën jo më pak se niveli i pagës minimale, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, dhe fondeve në dispozicion;
  - b) financimi/bashkëfinancimi i shpenzimeve operative të KOKSH-it dhe të Organizatës Kombëtare Antidoping, sipas veprimtarive të tyre përkatëse, për mbështetjen e sportistëve elitare, ekipeve kombëtare olimpike për sportet verore e dimërore dhe zbatimin e rregullave antidoping, kryerjen e testeve dhe kontrollit doping për sportistët që marrin pjesë në veprimtaritë kombëtare e ndërkombëtare, si dhe kryerjen e veprimtarive të edukimit antidoping e të parandalimit të tij.
5. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv financohen në bazë të programeve vjetore e të planeve të zhvillimit përkatës dhe nuk i nënshtrohen sistemit të pikëzimit.
6. Zërat e shpenzimeve, që lejohen të përballohen nga fondi buxhetor “Grant/transfertë korrente e brendshme” për federatat sportive olimpike, janë:
  - a) shpenzimet operative të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - b) trajtimi ushqimor, në natyrë ose në vlerë, i sportistëve të nivelit të lartë, si dhe pagesat e kontratave të shërbimit për trajnerët e ekipeve kombëtare, sipas rëndësisë së aktivitetit ndërkombëtar, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
  - c) shpenzimet për grumbullimin stërvitor të ekipeve kombëtare;
  - ç) sigurimi shëndetësor për sportistët e ekipeve kombëtare;
  - d) trajtimi mjekësor dhe shpenzimet e riaftësisimit të sportistëve, sipas përcaktimeve në ligjin për sportin;
  - dh) shpenzimet për pritje-përcjellje delegacionesh, konferenca, çmime etj., në nivelin e lejuar nga legjislacioni në fuqi;
  - e) shpërblimi për arritjen e rezultateve të larta sportive, sipas akteve ligjore e nënligjore;
  - ë) furnizimi me bazë materiale/uniforma sportive;
  - f) shpenzimet për seminare, trajnime, kualifikime dhe licencimi i trajnerëve, gjyqtarëve, mjekëve, fizioterapistëve, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor në sport;

- g) shpenzimet për analiza të kontrollit doping;
  - gj) shpenzimet e personelit, jo më pak se niveli i pagës minimale, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
7. Organizatat sportive, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, për të përfituar prej grantit nga buxheti i shtetit, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për sportin dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Projektprogramin afatmesëm, brenda datës 15 gusht të vitit korrent;
  - b) Kërkesën për mbështetje financiare, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3, të këtij vendimi, brenda datës 15 nëntor të vitit korrent;
  - c) Planin e detajuar të përdorimit të fondeve në dispozicion të përfituesit për vitin korrent, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga njoftimi zyrtar i përfitimit të transfertës;
  - ç) Planin e detajuar të aktiviteteve dhe objektivat konkretë, që do të arrihen/synohen të arrihen, si dhe programet e zhvillimit të disiplinës sportive apo funksionit të organizatës;
  - d) Kopjen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të përfituesve për ndarjen dhe përdorimin e fondeve publike.
8. Pas marrjes së kërkesës, struktura përgjegjëse pranë ministrisë, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, nëse konstatohen të meta, i cakton kërkuarit një afat prej 7 (shtatë) ditësh për plotësimin e të metave.
9. Për vlerësimin e aplikimeve të paraqitura në ministrinë përgjegjëse për sportin, ngrihet një komision *ad hoc* vlerësimi, i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, i cili mbledhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e fundit për paraqitjen e kërkesës, sipas shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij vendimi. Komisioni, nëse konstaton parregullsi, brenda 7 (shtatë) ditëve nga mbledhja e tij, njofton aplikuesit, duke iu caktuar afatin 5 (pesë) - ditor për plotësimin e tyre. Përbërja nominale e komisionit dhe formulari i aplikimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.
10. Komisioni i Vlerësimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e mbledhjes së tij të parë, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur, vlerëson për miratimin ose mosmiratimin e aktivitetit dhe i paraqet ministrit përgjegjës për sportin një raport të hollësishëm për këtë qëllim. Subjekti aplikues njoftohet për rezultatin e vlerësimit të komisionit brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e vendimmarrjes së tij. Aplikuesit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, mund të ankimojnë rezultatin e vlerësimit të komisionit te ministri përgjegjës për sportin. Vendimi për shpërndarjen e grantit miratohet nga ministri përgjegjës për sportin dhe i njoftohet zyrtarisht organizatave sportive përfituese.

11. Fondet alokohen në llogaritë bankare të nivelit të dytë të përfituesve nga ministria përgjegjëse për sportin.
12. Fondet buxhetore, që do t'i akordohen fondacioneve nga ministria përgjegjëse për sportin, duhet t'i nënshtrohen rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
13. Përjashtimisht për vitin 2026, kërkesa për mbështetje financiare, sipas shkronjës "b", të pikës 7, të këtij vendimi, do të paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
14. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar, Organizata Kombëtare Antidoping, federatat sportive olimpike, fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, dhe Këshilli i Arbitrazhit Sportiv për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDIRAMA**

MINISTRI I TURIZMIT,  
KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ENDRIT HOXHA

NR.PROT. 248/1  
DATË 21.1 .2026

MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR  
KOMITETIT PARALIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR  
ORGANIZATËS KOMBËTARE ANTIDOPING  
KËSHILLIT TË ARBITRAZHIT SPORTIV  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

